



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:147143
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05426441

2021:147144

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.(I.)H., nga fshati ..., Komuna Shtime, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Skender Jetishi nga Ferizaj, me objekt kontesti kompensim dëmi material, me vlerë të kontestit 459.00€, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konsiderohet se është tërhequr padia me shenjën 2021:147144 e paditëses KEDS, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit S.H., nga fshati ..., Komuna Shtime, me objekt kontesti kompensim dëmi material, me vlerë të kontestit 459.00€.

II. Detyrohet paditësja KEDS, me seli në Prishtinë, që të paditurit S.H. nga fshati ..., Komuna Shtime, të ja paguajë shpenzimet procedurale në lartësi prej 374,00€, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datë 07.07.2021 kundër të paditurit S.H., nga fshati ..., Komuna Shtime, me objekt kontesti kompensim dëmi material, me vlerë të kontestit 459.00€. Gjykata me datë 29.01.2024 ka mbajtur seancën përgaditore, në prezencë të autorizuarit të paditëses T.K. nga Ferizaj dhe të autorizuarit të paditurit av. Skender Jetishi nga Ferizaj, ku me aktvendimin procedural ftohet paditësja që brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e sotme të paguaj taksën për padi në shumën prej 20,00€ në të kundërtën padia mund të konsiderohet e tërhequr. Gjykata me datë 04.03.2024 ka mbajtur seancën kryesore, në të cilën ishin të pranishëm i autorizuari i të paditurit av. Skender Jetishi nga Ferizaj kurse nuk ishte i pranishëm e autorizuar e paditëses edhe pse ishin të ftuar në mënyrë të rregullt sipas procesverbalit të seancës së kaluar. Poashtu gjykata kishte konstatuar se në shkresat e lëndës mungon dëshmia mbi pagesën e taksës gjyqësore sipas urdhëresës nga seanca e kaluar. Në këtë seancë i autorizuari i të paditurit kërkoi nga gjykata që të konsiderohet e tërhequr padia e paditëses dhe i kërkoi shpenzimet e procedurës të specifikuar.

Andaj gjykata meqenëse paditësja kishte munguar në seancën e datës 04.03.2024 edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar, nuk kishte kërkuar shtyerjen e seancës, poashtu bazuar edhe në faktin se paditësja nuk e kishte paguar taksën për padi në lartësinë prej 20,00€, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 423.3 të LPK lidhur me nenin 253.5 të LPK që të konsiderohet e tërhequr padia e paditëses.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 452.1 dhe 463.1 të LPK sepse i padituri i specifikoi shpenzimet e procedurës konform TOAK.

Nga të gjitha të lartë cekurat e konform nenit 142 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 08.03.2024

Gj y q t a r i
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet të kësaj gjykate.